

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel akademik pranë Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel akademik në pozicionin “Lektor” në Departamentin e Inxhinierisë së Burimeve Minerare, Grupi Mësimor Kërkimor i Inxhinieri Miniere dhe Përpunim Mineralesh.

Kandidati duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:

1. Të ketë përfunduar studimet në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, ose Universitete të huaja në sistemin 5 (pesë) vjeçar në degën Inxhinier Miniere, Master Shkencor në Gjeoinxhinieri, Master Shkencor në Markshajderi (Gjeomatikë), ose në fushën e inxhinierisë së minierave në universitete jashtë vendit;
2. Të ketë notën mesatare të studimeve universitare (për studimet 5-vjeçare), të studimeve (Bachelor dhe Master i Shkencave) të jetë ≥ 8 (e barabartë ose më e lartë se 8);
3. Preferohet të ketë përvojë pune në fushën e nxjerrjes së mineraleve, projektimit në miniera si dhe në fushën e legjislacionit minerar dhe atë të menaxhimit.
4. Të ketë së paku gradën shkencore “Doktor”. Titulli akademik përbën përparësi.
5. Përvoja në mësimdhënie përbën përparësi.
6. Veprimtaria kërkimore dhe botuese në fushën e shfrytëzimit nxjerrjes së mineraleve të ngurta të dobishme dhe të gjeomjedisit përbëjnë përparësi.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet (origjinal ose kopje të noterizuar) si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimi (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje e gradës shkencore “Doktor”;
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton titujt dhe gradat, trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshmi e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **21.02.2025** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.